

# **ODA E PËRMBARUESVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT Shkup**

Kuvendi i Odës së Përmbauesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut Shkup, në bazë të nenit. 76 të Ligjit për përmbarim (“Gazeta zyrtare e R.M ” nr. 72, nga data 12.04.2016), në seancën e Kuvendit të mbajtur më 20.06.2016 në Shkup, miratoi Statutin e Odës, i ndryshuar dhe plotësuar në seancën e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të mbajtur më 30.10.2017 në Shkup, e ndryshuar dhe plotësuar në seancën e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të mbajtur më 25.06.2019, Kryetari i OPRMV Shkup me datën 17.09.2019 ka miratuar si vijon

## **STATUTIN**

**E ODËS SË PËRMBARUESVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË VERIORE Shkup**

**(teksti i pastruar)**

### **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

Me këtë Statut përcaktohet: emri i Odës së përmbauesve, selinë e Odës, vulën dhe vulën katërkëndëshe, organizimin, kompetencën, përbërjen, mënyrën e zgjedhjes, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, aktet e Odës, pasuritë dhe fondet e Odës, të drejtat dhe detyrimet e përmbauesve, zëvendësve të përmbauesve, ndihmësve të përmbauesve, praktikantëve tek përmbauesi në odën e përmbauesve, përgjegjësia disiplinore, anëtarësia, kryerja e veprimtarisë përmbauese, emëruesit e përmbauesve, zëvendësit dhe ndihmësit, praktikantët tek përmbauesi, shërbimi profesional i Odës së përmbauesve, si dhe dispozitat e tjera të funksionimit të përmbauesve dhe të Odës së Përmbauesve.

#### **Neni 2**

Përmbauesit dhe zëvendës përmbauesit në Republikën e Maqedonisë së Veriut detyrimisht i bashkohen Odës së Përmbauesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut Shkup (në tekstin e mëtejshëm: Odës) e cila vepron në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Emri i shkurtuar i Odës është OPRMV Shkup.

#### **Neni 3**

Selia e Odës së përmbauesve është në Shkup. Oda e ka cilësinë e personit juridik.

#### **Neni 4**

Orari i punës së Odës për pranimin e postës dhe punën me palët përcaktohet me vendim të Këshillit Drejtues.

Orari i punës i Odës shfaqet në mënyrë të dukshme para hyrjes në ambientet e Odës dhe në ueb faqen lokacionin e Odës së përmbaruesve.

#### **Neni 5**

Oda ka shenjën-stemën e saj mbrojtëse (logon).

Formën dhe përmbajtjen e shenjës mbrojtëse (stemës) e përcakton Kuvendi i Odës, me propozim të Këshillit Drejtues.

- “Oda e përmbaruesve ka pllakën e saj për shënimin e ambienteve zyrtare të selisë së Odës, në formë drejtkëndëshe me përmbajtje:  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
Oda e Përmbaruesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut”
- Teksti në pllakë është i shkruar në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e tij cirilik, në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe shkrimin e tij, si dhe në anglisht, me të njëjtën madhësi dhe font, gjatë secilës titulli në gjuhën maqedonase dhe shkrimin shkruhet së pari.

Pllaka i ka këto dimensione: 50 centimetra në bazë dhe 30 centimetra në lartësi.

#### **Neni 6**

Oda ka vulën dhe vulën katërkëndëshe të saj.

Vula ka formë të rumbullakët me diametër prej 4 cm.

“Teksti i vulës është i shkruar në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik dhe në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve dhe shkrimin e saj”

Në pjesën e brendshme të vulës në formë gjysmërrethi është shkruar teksti vijues: “Republika e Maqedonisë së Veriut”, pastaj “Oda e Përmbaruesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut Shkup”. Në mes të vulës është stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nën stemën e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndodhet selia “Shkup”.

Në skajin e vulës në formë të rrethit janë shënuar dy vija të holla paralele.

## **Neni 7**

Vula katërkëndëshe e Odës ka formë drejtkëndëshe me këtë përmbajtje:

“Shenja e stemës së Republikës së Maqedonisë së Veriut

Republika e Maqedonisë së Veriut

ODA E PËRMBARUESVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT Shkup

Hapësira e zbrazët për numrin dhe datën e aktit

S h k u p"

Vula katërkëndëshe i ka këto dimensione: gjatësia 7 cm, gjerësia 3,5 cm.

“Teksti i vulës është i shkruar në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj cirilik dhe në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve dhe shkrimin e saj”.

## **Neni 8**

Oda për detyrimet e saj përgjigjet me të gjitha mjetet e saj.

## **Neni 9**

Odën e prezanton dhe përfaqëson Kryetari i Odës .

Të drejtat dhe detyrimet e kryetarit të Odës së përmbaruesve përcaktohen në përputhje me ligjin dhe me dispozitat e këtij Statuti, si dhe me aktet e tjera të Odës.

## **Neni 10**

Oda është anëtare e Unionit Ndërkombëtar të Përmbaruesve (UIHJ).

Oda, me vendim të Këshillit Drejtues, mund të përfaqësohet edhe në shoqata të tjera të fushës së të drejtës dhe shoqata të juristëve.

## **Neni 11**

Çdo përmbarues, zëvendës dhe ndihmës përmbarues, përpara se të fillojë punën, duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin që e udhëheq Oda.

Praktikanti te përmbaruesi doemos duhet të regjistrohet në Regjistrin e praktikantëve tek përmbaruesit të cilin e udhëheq Oda.

Në Odën e përmbauesve mund të anëtarësohen edhe anëtarët e nderit.

## **II. QËLLIMET E ODËS DHE MËNYRA E REALIZIMIT TË TYRE**

### **Neni 12**

Objektivat kryesore të Oda janë:

- avancimi, koordinimi dhe zhvillimi i shërbimit përmbaues në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si shërbim që e kryejnë personat me kompetenca publike, që veprojnë në pajtim me Ligjin për përmbarim dhe aktet nënligjore nga kjo fushë, si dhe rregulloret tjera ligjore;
- mbrojtja e autonomisë dhe pavarësisë së përmbauesve në kryerjen e shërbimit;
- trajnime profesionale të vazhdueshme të përmbauesve, zëvendës përmbauesve dhe ndihmës përmbauesve;
- realizimi i bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar me Odat dhe shoqatat nacionale të përmbauesve dhe anëtarësimi dhe aktiviteti i Odës në Unionin Ndërkombëtar të Përmbauesve (UIHJ).

Oda gjithashtu kujdeset për:

- sigurimin e kushteve për kryerjen e duhur, të suksesshme dhe të pavarur të shërbimit

### **Neni 13**

Qëllimet e veta Oda i arrin nëpërmjet:

- organizimit të takimeve të rregullta me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe përfaqësues të organeve tjera shtetërore, gjykatave, institucioneve, regjistrave publikë, subjekteve të transaksionit të pagesës dhe subjekteve tjera me të cilat është i lidhur funksionimi i përmbauesve;
- inicimin e pyetjeve dhe propozimeve në lidhje me rregulloret ligjore dhe nënligjore në Ministrinë e Drejtësisë që kanë të bëjnë me kryerjen më efikase të ekzekutimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- monitorimin aktual të situatave në zbatim, përpunimi i analizave dhe raporteve vjetore për punën e Odës;
- organizimi i seminareve dhe ligjëratave, në bashkëpunim me institucione dhe shoqatat shkencore dhe profesionale nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë saj, për temat

e përmbartimit dhe në përgjithësi për funksionimin e sistemit juridik dhe sundimin e ligjit në interes të shërbimit;

- themelimi i buletinit të Odës në funksion të informimit për veprimtarinë e Odës dhe kryerjen e shërbimit;
- bashkëpunimin e menduar dhe organizuar me mediat publike, në funksion të informimit të publikut për shërbimin përmbartimor dhe sigurimit të transparencës në punën e përmbartuesve si dhe realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve, debitorëve dhe pjesëmarrësve dhe personave të tretë në ekzekutim.

#### **Neni 14**

Qëllimet e saj Oda i rregullon dhe kryen në përputhje me Kushtetutën, ligjet, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me ligjin, aktet nënligjore, dispozitat e këtij Statuti dhe aktet e tjera të Odës.

#### **Neni 15**

Oda i përfaqëson dhe mbron interesat e anëtarëve të saj.

#### **Neni 16**

Oda udhëheqë regjistra elektronik të përmbartuesve, zëvendës përmbartuesve, ndihmësve të përmbartuesve dhe praktikantëve tek përmbartuesi.

#### **Neni 17**

Oda ka librat e saj të protokollit që i udhëheqë në formë elektronike.

### **III. ORGANET E ODËS**

#### **Neni 18**

1) Organet e Odës janë:

- Kuvendi;
- Këshilli Drejtues;
- Kryetari i Odës;
- Komisioni Disiplinor;

- 2) Kuvendi dhe Këshilli Drejtues i Odës mund të themelojnë komisione dhe trupa punuese të Odës të natyrës së përhershme dhe të përkohshme. Komisionet dhe trupat punuese të Odës nuk janë organe të Odës.

Me aktin e themelimit dhe me rregullat për punën e komisionit apo trupit punues përkatës përcaktohet mënyra e punës, përbërja, mandati, kompetencat dhe përgjegjësia e komisioneve dhe trupave punuese.

## **1. Kuvendi i Odës**

### **Neni 19**

Kuvendi është organi më i lartë i Odës që mbron reputacionin dhe nderin e kryerjes së shërbimit dhe siguron që përmbaruesit të ushtrojnë kompetencat e tyre me ndërgjegje dhe në përputhje me ligjin.

Kuvendin e Odës e përbëjnë të gjithë përmbaruesit e territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kuvendi i Odës mban seancë të rregullt një herë në vit edhe atë gjatë muajit shkurt.

Kuvendi, nëse është e nevojshme mund të mbajë edhe seancë të jashtëzakonshme.

### **Neni 20**

Anëtarët e Kuvendit njoftohen për seancën e paraparë të Kuvendit të paktën 15 ditë para ditës së mbajtjes së tij, e në raste urgjente ajo mund të jetë edhe më shpejt.

Seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Odës mund të thërrasë kryetari i Odës, me vendim të Këshillit Drejtues, ose me kërkesë me shkrim të së paku 30 anëtarëve të Odës. Nëse kryetari i Odës nuk e thërret seancën brenda një muaji nga dita e marrjes së vendimit nga Këshilli drejtues, gjegjësisht nga paraqitja e kërkesës me shkrim nga anëtarët e Odës për thirrjen e seancës, seancën e thërret anëtari i Këshillit Drejtues i përcaktuar nga ky organ, përkatësisht anëtarët e Odës të cilët e kanë paraqitur kërkesën për thirrjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm.

### **Neni 21**

Mënyra e mbledhjes, puna e Kuvendit, rendi dhe disiplina, përcaktimi i rendit të ditës, si dhe mënyra e marrjes së vendimeve rregullohen me Rregulloren e punës së Kuvendit.

## Neni 22

### Kuvendi i Odës së përmbaruesve

- sjellë Statutin dhe aktet tjera të Odës;
  - sjellë Kodin e etikës profesionale të përmbaruesve;
  - sjellë Rregullore për përgjegjësinë disiplinore dhe zhvillimin e procedurës disiplinore;
  - sjellë vendime, konkluzione dhe rekomandime;
  - zgjedh Kryetarin e Odës;
  - zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues;
  - zgjedh anëtarët e Komisionit Disiplinor;
  - zgjedh Këshillin Mbikëqyrës;
  - zgjedh komisionet dhe organet tjera punuese të Odës (të përhershme ose të përkohshme);
  - përcakton mënyrën e komunikimit me organet shtetërore, bankat, ndërmarrjet publike dhe subjektet e tjera gjatë mbledhjes së të dhënave për debitorin;
  - jep mendim deri te Ministri i drejtësisë për propozimin e tarifës për shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve të tjera për punën e përmbaruesve;
  - shqyrton propozimet, kërkesat dhe rekomandimet për funksionimin e suksesshëm të Odës dhe përmbaruesve;
  - miraton llogarinë përfundimtare vjetore për vitin e kaluar dhe propozimin e llogarisë për vitin e ardhshëm, shqyrton dhe miraton raportin për aktivitetet e përgjithshme, të përgatitur nga kryetari i Odës;
  - miraton Rregulloren për formën e pllakës për shënjimin e lokaleve zyrtare të përmbaruesit me propozim të Këshillit drejtues të OPRMV Shkup, Rregulloren për punën e Komisionit për kontroll të brendshëm për aplikimin e tarifës.
- dhe e miraton Rregulloren për punën e Këshillit Mbikëqyrës të OPRMV Shkup me propozim të Këshillit Drejtues të OPRMV Shkup;
  - vendos për shumën e anëtarësisë dhe mënyrën e pagesës së saj;
  - vendos për përdorimin e mjeteve të përfituara nga pagesa e gjobave nga procedurat disiplinore;
  - shpërndanë Pllakë për merita të veçanta, me propozim të Këshillit Drejtues dhe
  - vendos për të gjitha çështjet e tjera të parashikuara me ligj dhe me Statutin e Odës .

## Neni 23

Kryetari i Odës, anëtarët e Këshillit Drejtues, të Komisionit Disiplinor dhe komisionet dhe organet e karakterit të përhershëm të zgjedhur nga Kuvendi zgjidhen për një periudhë trevjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Përzgjedhja e organeve bëhet me votim të fshehtë, në procedurë të përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit.

Mandati i anëtarëve të komisioneve dhe organeve të tjera të përkohshme të zgjedhur nga Kuvendi rregullohet me aktin për formimin e tyre.

## **Neni 24**

Kuvendin e udhëheq Kryetari, ndërsa në rast të pamundësisë ose mungesës së tij me Kuvendin udhëheq nënkryetari, e në pamundësi të nënkryetarit anëtari më i vjetër i Këshillit Drejtues.

## **Neni 25**

Kuvendi i Odës kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjit dhe akteve të tjera nënligjore që bëjnë pjesë në fushëveprimin e çështjeve që lidhen me kryerjen e shërbimit.

## **2. Këshilli drejtues**

### **Neni 26**

Këshilli drejtues është organi administrativ dhe e përmbaruesve i Odës.

Numrin e anëtarëve të Këshillit Drejtues e përcakton Kuvendi. Numri i anëtarëve të Këshillit të Drejtues duke përfshirë edhe Kryetarin e Këshillit drejtues është tek.

Kryetari i Odës është edhe Kryetar i Këshillit Drejtues.

Seancat e Këshillit Drejtues i thërret kryetari i Odës.

Anëtari i Këshillit drejtues të Odës për kohëzgjatjen e mandatit të tij nuk mund të jetë njëkohësisht edhe anëtar i ndonjë organi tjetër të Odës.

Mbledhja e Këshillit Drejtues mund të thirret edhe me kërkesë të një të tretës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Këshilli drejtues mund të marrë vendime të vlefshme nëse në seancë marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit drejtues.

Këshilli drejtues i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në seancën e Këshillit drejtues me votim të hapur.

Për propozimin e Statutit dhe ndryshimet e tij, për llogarinë vjetore, për blerjen e mjeteve bazë, Këshilli drejtues mund të marrë vendim të vlefshëm nëse për të kanë votuar shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit drejtues.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes, drejtimit, funksionimit dhe vendimmarrjes së Këshillit drejtues rregullohet me Rregulloren e Punës së Këshillit drejtues.

## Neni 27

Këshilli drejtues i ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- harton draftin e statutit dhe akteve të tjera të Odës;
- përgatit dhe i paraqet ministrisë propozime dhe mendime lidhur me pozitën bazë të përmbaruesit, si dhe për të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me detyrën e përmbaruesit;
- ndërmerri dhe zbaton iniciativë për shqyrtimin e çështjeve me interes për përmbaruesit, si që janë çështjet e mbrojtjes sociale të përmbaruesve, krijimi i fondit solidar për ndihmën ekonomike për përmbaruesit, si dhe fond për asistencën për personat që janë të trajnuar në mënyrë të përhershme për kryerjen e pavarur të veprimtarisë dhe çështjeve për organizimin e sigurimit të përhershëm të përmbaruesve;
- themelon Komisionin për mbikëqyrjen e punës së përmbaruesve me qëllim të sjelljes uniforme të përmbaruesve dhe zbatimit korrekt të tarifës dhe jep iniciativën për fillimin e procedurës disiplinore;
- themelon Komisionin për zbatimin e konkursit për emërimin e përmbaruesve;
- miraton Programin për arsimim të detyrueshëm të vazhdueshëm të përmbaruesve dhe zëvendësve të përmbaruesve të propozuar nga Komisioni për arsimim i cili kryen mbikëqyrje për aftësimin profesional të përmbaruesve dhe lëshon certifikata për aftësimin profesional të zbatuar, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga përmbaruesi për të cilin kryhet trajnimi;
- kujdeset për statusin e përmbaruesve dhe marrëdhëniet me autoritetet dhe institucionet e tjera për të promovuar detyrën përmbaruese;
- e organizon aftësimin e vazhdueshëm profesional të përmbaruesve duke organizuar seminare, ligjërata dhe forma të tjera në përputhje me Programin e Arsimit. Pjesëmarrja në seminare dhe ligjërata është e detyrueshme për përmbaruesit, zëvendësit e përmbaruesve dhe ndihmësit e përmbaruesve, ndërsa mungesa e tyre e pajustificuar përbën shkelje disiplinore;
- udhëheqë Regjistër të përmbaruesve, zëvendësve të përmbaruesve, ndihmësve të përmbaruesve, praktikantëve dhe vullnetarëve tek përmbaruesit në formë elektronike;
- i përgatit seancat e Kuvendit të Odës;
- i ekzekuton vendimet e Kuvendit të Odës;

- përgatit propozim raport financiar vjetor për punën e Odës dhe propozim plan financiar për vitin e ardhshëm;
- kujdeset për mbledhjen e anëtarësisë dhe nis procedurën për mbledhjen e detyruar të anëtarësisë;
- nga radhët e anëtarëve të saj zgjedh nënkryetar të Odës;
- zgjedh Këshill profesional prej pesë anëtarëve;
- kryen mbikëqyrje mbi punën e përmbaruesve dhe jep iniciativë për kryerjen e inspektimit të jashtëzakonshëm për fillimin e procedurës disiplinore;
- formon Komisionin për arsim të vazhdueshëm;
- themelon Komisionin për kontroll të brendshëm për zbatimin e tarifës;
- kujdeset për statusin e përmbaruesit dhe marrëdhëniet me autoritetet e tjera dhe në përgjithësi me palët e treta;
- bashkëpunon me ministritë kompetente dhe formon grupe punuese për përgatitjen e rregulloreve që kanë të bëjnë, përkatësisht që janë të lidhura me zbatimin;
- jep rekomandime edhe mendime me qëllim të zbatimit më të suksesshëm të zbatimit dhe unifikimit të praktikës dhe miraton mendimet ligjore të propozuara nga Këshilli Profesional i Odës;
- përcakton dhe propozon propozim llogaritje për vitin e ardhshëm;
- përgatit rregullisht dhe i paraqet Ministrit të Drejtësisë propozime dhe mendime për organizimin bazë të shërbimit, si dhe për çështje të tjera që lidhen me profesionin e përmbaruesit, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve për përmirësimin e gjendjes;
- i përgatit aktet e Odës të cilat i sjellë Kuvendi;
- përgatit propozime për krijimin e fondeve, veçanërisht për: mbrojtje sociale, solidaritet, ndihmë ekonomike, për nevoja të përbashkëta, për përmirësim, specializim dhe nevoja të tjera;
- vendos për blerjen dhe shitjen e mjeteve elementare;

- vendos për pjesëmarrjen në seminare, konferenca, sesione pune dhe mbledhje të UIHJ-së jashtë vendit;
- për punësimin e punëtorëve profesional-administrativ në Odë;
- për trajnim profesional jashtë vendit;
- për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve nga fondet e Odës;
- vendos për shumën e tarifës së regjistrimit në Odën e përmbauesve dhe mënyrën e pagesës;
- për mënyrën e përdorimit të mjeteve të përfituara nga pagesa e gjobave;
- kujdeset për sigurimin e ligjshmërisë dhe zbatimit korrekt të të gjitha akteve në Odën e përmbauesve;
- ndërmerri masa për mbrojtjen e pasurisë së Odës;
- propozon ndarje të Pllakës për merita të veçanta;
- dhuron Falënderime dhe Mirënjohje për bashkëpunim të suksesshëm me propozim të Kryetarit të Odës;
- e sjellë Rregulloren për shumën dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit të anëtarëve të organeve dhe komisioneve të Odës së përmbauesve të RMV Shkup;
- e sjellë Rregulloren për punën e Komisionit për mbikëqyrjen e punës së përmbauesve dhe zbatimin e drejtë të tarifës.
- miraton Rregullore për sistemimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të Odës së Përmbauesve të RMV Shkup.
- e propozon draft Rregulloren për punën e Këshillit Mbikëqyrës të OPRMV Shkup;
- e zgjedh kryeredaktorin dhe përgjegjës dhe përcakton periudhën e botimit si dhe mënyrën e financimit të botimit të buletinit të Odës;
- vendos edhe për çështje të tjera me ligj ose me këtë Statut që janë në kompetencë të saj, si dhe për ato çështje që janë në interes për Odën dhe të ekzekutimit dhe që nuk përcaktohen në kompetencën e asnjë organi tjetër.

## **Neni 28**

- 1) Kuvendi mund të shkarkojë anëtarin ose të gjithë Këshillin Drejtues edhe para përfundimit të mandatit, nëse:

- nuk mblidhet brenda 30 ditëve nga dita e zgjedhjeve;
- punon në kundërshtim me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të Odës;
- i shkakton dëm Odës ose anëtarëve të saj;
- nuk i kryen detyrimet e tij të cilat është i detyruar t'i kryejë në përputhje me ligjin përmbartimor, aktet nënligjore dhe këtë statut;
- nuk i ekzekuton vendimet e Kuvendit, respektivisht i ekzekuton jo në kohën e duhur;
- nuk përgatit propozim për llogaritje vjetore dhe propozim për llogaritje për vitin pasardhës;
- nuk përgatit dhe propozon Program për edukimin e vazhdueshëm të përmbartuesve dhe nuk organizon aftësimin e vazhdueshëm profesional të përmbartuesve;
- nuk kujdeset për arkëtimin e duhur të anëtarësimit.

2) Kuvendi mund të shkarkojë anëtar të Këshillit drejtues edhe para përfundimit të mandatit nëse:

- nuk i kryen detyrat e tij në Këshillin drejtues si anëtar i tij ose i kryen ato në kohën jo të duhur;
- nuk përgatit dhe nuk dorëzon raporte në Këshillin Drejtues për mbledhje, takime, pjesëmarrje në seminare, konferenca, trupa punues në kuvendin e ministrive dhe autoriteteve, në të cilat ka marrë pjesë si anëtar i Këshillit drejtues dhe e ka përfaqësuar Odën e përmbartuesve;
- në mënyrë të pajustificueshme nuk merr pjesë në mbledhje pune, takime, seminare, konferenca dhe ngjarje të tjera në të cilat Këshilli drejtues, gjegjësisht Kryetari i Odës së Përmbartuesve, është përcaktuar të marrë pjesë si anëtar i Këshillit drejtues dhe ta përfaqësojë Odën e përmbartuesve;

3) Anëtar i Këshillit Drejtues të cilit i është shqiptuar masa disiplinore për kundërvajtje disiplinore nuk ka të drejtë të zgjidhet në organet e Odës brenda një viti nga dita e marrjes së masës disiplinore.

Anëtarit të Këshillit drejtues, i cili me vendim të formës së prerë është dënuar me burgim të pakushtëzuar prej më shumë se gjashtë muaj, ose është dënuar me ndalim të ushtrimit të profesionit të përmbartuesit, me vendim të gjykatës i është hequr ose kufizuar aftësia e veprimtarisë ose është dënuar me vendim të Komisionit disiplinor masë disiplinore heqje e përhershme e së drejtës për të kryer detyrën e përmbartuesit për shkelje disiplinore të kryer, i mbaron mandati në ditën e fshirjes nga Regjistri i Përmbartuesve që udhëhiqet nga Oda e Përmbartuesve;

4) Anëtar i Këshillit drejtues mund t'i kërkojë Kuvendit që ta lirojë nga kompetencat e anëtarit të Këshillit drejtues nëse, për shkaqe të arsyeshme, ai pengohet të kryejë me kohë detyrat e tij si anëtar i Këshillit drejtues. Kërkesa i paraqitet Këshillit drejtues, i cili nëse shkaqet janë të arsyeshme i propozon Kuvendit lirin e anëtarit të Këshillit drejtues nga detyra.

### 3. Kryetari i Odës

#### Neni 29

Kryetari i Odës i ka këto të drejta dhe obligime:

- e prezanton dhe përfaqëson Odën.
- kujdeset dhe përgjigjet që Oda të veprojë në përputhje me ligjin;
- lëshon vërtetim për përvojën e praktikantit dhe vullnetarëve në bazë të evidencës nga regjistrat e praktikantëve dhe vullnetarëve, si dhe vërtetime të tjera nga evidenca që i udhëheq Oda;
- kujdeset dhe përgjigjet për mundësimin e mbikëqyrjes mbi Odën dhe për saktësinë e të dhënave dhe shënimeve gjatë mbikëqyrjes, si dhe për marrjen e masave për eliminimin e mangësive të konstatuara nga mbikëqyrja brenda afateve të përcaktuara nga Ministria;
- zgjidh konfliktet ndërmjet përmbauesve, ose ndërmjet përmbauesve dhe palëve të tyre, që i referohen zbatimit të këtij ligji;
- cakton seancat e Kuvendit dhe të Këshillit Drejtues;
- zbaton vendimet e Kuvendit, përveç atyre vendimeve për të cilat është kompetent Këshilli drejtues ;
  
- i zbaton vendimet e Këshillit Drejtues;
- i ekzekuton vendimet e Komisionit Disiplinor;
- i nënshkruan procesverbalet dhe vendimet e Kuvendit dhe të Këshillit Drejtues;
- i nënshkruan aktet e përgjithshme të Odës dhe kujdeset për ekzekutimin e tyre;
- i nënshkruan urdhrat e udhëtimit për udhëtim brenda dhe jashtë vendit;
- e organizon dhe koordinon shërbimin profesional të Odës;
- siguron që funksionimi i Odës të kryhet sipas rregulloreve ligjore, Statutit dhe akteve të tjera të Odës;
- përgatit Raport vjetor për aktivitetet e përgjithshme të Odës, veçanërisht duke përfshirë punën e Kryetarit, Këshillit Drejtues dhe organeve tjera dhe ia paraqet Kuvendit të Odës në seancën e rregullt vjetore;
- kujdeset për mbrojtjen e reputacionit të Odës, të përmbauesve dhe të shërbimit përmbaues në përgjithësi;
- sjellë vendime, urdhra, udhëzime dhe urdhra, veçanërisht për zbatimin e vendimeve të Kuvendit, të Këshillit Drejtues, të Komisionit Disiplinor, si dhe të vendimeve të Ministrisë të Drejtësisë ose të kryetarit të gjykatës themelore;
- i propozon Këshillit Drejtues dhënien e Falënderimit dhe Mirënjohjes për bashkëpunim të suksesshëm dhe Pllakë për kryerjen me sukses të shërbimit përmbaues.
- e propozon Rregulloren e Punës së Komisionit të Kontrollit të Brendshëm për zbatimin e Tarifës;
- e propozon Rregulloren për sistemimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të Odës së Përmbauesve të RMV Shkup;
- sjellë vendime për regjistrimin në regjistrat e përmbauesve, zëvendësve, ndihmësve dhe praktikantëve që i udhëheq Oda;

- i propozon anëtarët e Komisionit për zbatimin e konkursit për emërimin e përmbaruesve;
- i zgjedh lëndët e propozuara nga Fakultetet Juridike nga universitetet e akredituara në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- jep mendim për konstatimin e plotësimit të kushteve të hapësirave të punës dhe pajisjes së përmbaruesit në përputhje me Rregulloren për llojin e pajisjeve dhe hapësirës që kërkohet për kryerjen e shërbimit;
- merr vendim për caktimin e ditës kur fillon puna e përmbaruesit dhe e zbaton shpalljen e tij në Gazetën Zyrtare të RMV-së;
- sjellë vendim për autorizimin e përmbaruesit që është caktuar me vendim të Ministrit të Drejtësisë për të marrë dhe vazhduar punën për çështjet e përmbaruesit të cilit i ka pushuar shërbimi në disponim me llogarinë e veçantë të përmbaruesit të cilit i ka pushuar shërbimi;
- drejton me Komision të përbërë nga kryetari, një anëtar i Këshillit drejtues, zëvendësi i përmbaruesit të cilit i ka pushuar shërbimi dhe sekretarit të Odës me qëllim të kryerjes së procedurës për regjistrimin dhe pranimin e dosjeve, objekteve, librave dhe procesverbaleve të përmbaruesit të cilit i ka pushuar shërbimi dhe pranimit- dorëzimit të përmbaruesit, i cili me vendim të Ministrit të Drejtësisë është emëruar për të marrë dhe vazhduar punën për rastet e përmbaruesit të cilit i ka pushuar shërbimi;
- kryen detyra të tjera që i ngarkohen me ligj, akte nënligjore, me këtë Statut dhe akte të tjera të përgjithshme të Odës.

Në rast të paaftësisë së kryetarit, detyrat e tij i kryen nënkryetari i Odës. Në rast se pengohet edhe nënkryetari, detyrën e kryen anëtar i më i vjetër i Këshillit Drejtues.

Kryetari i Odës, për kohëzgjatjen e mandatit të tij, nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i organeve të tjera të Odës, përveç atyre në të cilat është anëtar me ligj.

### **Neni 30**

Kryetari i Odës mund të shkarkohet nga detyra e Kryetarit nga Kuvendi i Odës nëse:

- nuk punon në përputhje me rregulloret ligjore, nuk respekton dispozitat e këtij Statuti, vendimet e Kuvendit dhe të Këshillit Drejtues, të Komisionit Disiplinor dhe nuk i zbaton ose nuk i zbaton në kohën e duhur;
- me punën e tij si kryetar i ka shkaktuar dëm material Odës ose anëtarit të saj;
- nuk ekzekuton vendimet e Komisionit Disiplinor;
- nuk i paraqet Kuvendit raport vjetor për punën e përgjithshme të Odës në seancën e rregullt vjetore, përkatësisht të njëjtin e dorëzon me vonesë;

Kryetarit i përfundon mandati në ditën e fshirjes së tij nga Regjistri i përmbaruesve të cilën e udhëheq Oda e Përmbaruesve, nëse ai dënohet për veprë penale me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe dënohet me burgim të pakushtëzuar më shumë se gjashtë muaj, ose dënohet me ndalim të ushtrimit të profesionit të përmbaruesit, me vendim gjykate, i hiqet ose i kufizohet aftësia e veprimtarisë, ose nga ana e Komisionit Disiplinor i shqiptohet masa disiplinore duke i hequr përgjithmonë të drejtën për të kryer shërbimin e përmbaruesit.

Në rast të shqiptimit të ndalesës së përkohshme të kryerjes së shërbimit, pezullimit nga Komisioni Disiplinor të përmbaruesit që është kryetar i Odës, i pushon mandati dhe i njëjti nuk mund të marrë pjesë në punët e Odës apo ta përfaqësojë Odën, ndërsa Nënkryetari për kohëzgjatjen e pezullimit shërben si kryetar i Odës. Pas revokimit të pezullimit të vendosur, në rast se vërtetohen arsyet që e kanë nisur atë, nënkryetari është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të vendimit të revokojë ndalimin e përkohshëm të kryerjes së shërbimit-pezullim, të thërrasë seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit me qëllim të shkarkimit të kryetarit dhe zgjedhjen e kryetarit të ri të Odës.

Iniciativë për shkarkimin e kryetarit të Odës mund të jepet nga Këshilli Mbikëqyrës, nga së paku tre anëtarë të Këshillit Drejtues ose së paku një e treta e anëtarëve të Kuvendit të Odës.

Propozimin për shkarkimin e kryetarit të Odës e përcakton Këshilli Drejtues, ndërsa vendimin për shkarkim e merr Kuvendi i Odës më së voni në afat prej 15 ditësh. Vendimi sillet me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i përmbaruesve të regjistruar në regjistrë që kanë filluar punën.

#### **4. Komisioni Disiplinor**

##### **Neni 31**

Komisioni disiplinor përbëhet nga pesë anëtar, nga të cilët dy anëtar janë nga radhët e gjyqtarëve me propozim të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, një anëtar me propozim të Këshillit të prokurorëve publikë dhe dy anëtar nga Oda e përmbaruesve.

Anëtarët e Komisionit Disiplinor kanë zëvendës.

Anëtarët e Komisionit Disiplinor dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga Kuvendi i Odës, përkatësisht anëtarët e Odës me propozimin e përmbaruesve, ndërsa anëtarët nga radhët e gjyqtarëve dhe zëvendësit e tyre me propozimin me shkrim të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe një anëtar dhe zëvendësi i tij me propozim me shkrim të Këshillit të prokurorëve publikë, me shumicë votash nga të pranishmit me votim të fshehtë. Mandati i kryetarit dhe i anëtarit dhe zëvendësve të tyre zgjat tre vjet me të drejtë edhe për një rizgjedhje. Mënyra e propozimit dhe zhvillimit të votimit do të rregullohet me Rregulloren e punës Kuvendit.

Komisioni Disiplinor në mbledhjen e parë do të zgjedhë nga radhët e përmbaruesve një kryetar, anëtarë të komisionit dhe zëvendëskryetar të komisionit disiplinor.

##### **Neni 32**

Komisioni Disiplinor zbaton procedurën disiplinore, në bazë të propozimit të parashtruesit të autorizuar.

### **Neni 33**

Të drejtat dhe kompetencat, udhëheqja e procedurës, si dhe sjellja e vendimit rregullohen me Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore dhe procedurën disiplinore.

### **Neni 34**

Kryetari i OPRMV Shkup ka të drejtë në kompensim.

Shumën për kompensim, me vendim e përcakton Këshilli drejtues i OPRMV Shkup.

Zgjedhja e kryetarit të OPRMV Shkup, anëtarët e Këshillit drejtues, anëtarët e Komisionit disiplinor, anëtarët e Këshillit mbikëqyrës rregullohen me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Anëtarët e komisioneve dhe trupave punuese kanë të drejtë në kompensim për shpenzimet e udhëtimit.

## **IV. Komisionet dhe trupat punuese të Odës së përmbauesve**

### **1. Këshilli profesional**

#### **Neni 35**

Këshilli profesional është trup profesional i Odës. Këshilli profesional zgjidhet nga Këshilli drejtues i Odës. Këshilli profesional përbëhet nga pesë anëtar.

Rregullat e punës dhe kushtet për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit profesional rregullohen me rregulloren e punës së Këshillit profesional të miratuar nga Këshilli drejtues i OPRMV Shkup.

### **2. Këshilli Mbikëqyrës i Odës së përmbauesve**

#### **Neni 36**

Këshilli mbikëqyrës i Odës përbëhet nga kryetari dhe dy anëtar, të zgjedhur nga Kuvendi i Odës nga radhët e anëtarëve të saj. Këshilli mbikëqyrës është komision me karakter të përhershëm. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Odës nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë të organeve të Odës, përkatësisht të një komisioni tjetër të Odës, përveç në ato organe në të cilat janë anëtarë sipas ligjit.

#### **Neni 37**

Këshilli Mbikëqyrës monitoron zbatimin e dispozitave të këtij Statuti dhe akteve të tjera të përgjithshme të Odës, nga ana e organeve dhe trupave të Odës.

Rregullat për punën e Këshillit Mbikëqyrës përcaktohen me Rregullore për punën e Këshillit Mbikëqyrës, të cilat i miraton Kuvendi i Odës me propozimin e Këshillit Drejtues të Odës.

### **Neni 38**

Këshilli Mbikëqyrës kontrollon funksionimin material dhe financiar të Odës, si dhe mënyrën e përdorimit të fondeve të Odës.

### **Neni 39**

Të gjitha organet dhe trupat e Odës janë të obliguara që të ofrojnë kushte për punën e Këshillit Mbikëqyrës, lidhur me ushtrimin e mbikëqyrjes.

### **Neni 40**

Këshilli Mbikëqyrës është i detyruar t'i paraqesë Kuvendit të Odës raport për punën e tij, për zbatimin e Statutit dhe akteve të tjera të përgjithshme të Odës, si dhe për punën materiale dhe financiare të Odës, të paktën një herë në vit, gjatë miratimit të raporteve dhe programeve të punës për vitin paraprak dhe llogarisë përfundimtare të Odës në seancën e rregullt vjetore të Kuvendit.

### **Neni 41**

Mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës e thërret dhe udhëhiqet nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës.

Për kontrollin, mbikëqyrjen e kryer ose seancën e mbajtur mbahet procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Këshilli mbikëqyrës kryen mbikëqyrje të rregullt mbi punën e Odës së paku një herë në vit, gjatë së cilës kontrollon funksionimin material dhe financiar të Odës, si dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve të Odës nga organet dhe trupat e Odës. Për ditën e mbikëqyrjes njoftohet Kryetari i Odës së Përmbaruesve tre ditë para datës së mbikëqyrjes në Odë.

Këshilli Drejtues është i obliguar që çdo tre muaj t'i dorëzojë Këshillit Mbikëqyrës raport financiar për punën e Odës. Këshilli Mbikëqyrës është i obliguar që në bazë të raportit financiar t'i vërë në dukje Këshillit Drejtues mangësitë e konstatuara dhe të japë rekomandime për largimin e tyre.

Këshilli Drejtues është i obliguar t'ia dorëzojë Këshillit mbikëqyrës draft llogarinë përfundimtare (pasqyrën vjetore) për vitin paraprak së paku 10 ditë para ditës së mbajtjes së seancës së Kuvendit të rregullt vjetor të Odës.

Këshilli Mbikëqyrës është i autorizuar të kryejë mbikëqyrje të jashtëzakonshme mbi punën e Odës me qëllim të monitorimit të zbatimit të dispozitave të këtij Statuti dhe akteve të tjera të përgjithshme të Odës, nga organet dhe komisionet e Odës në bazë të vendimit të Kryetari të Këshillit Mbikëqyrës ose me iniciativën e së paku 5 anëtarëve të Kuvendit të Odës.

Këshilli Mbikëqyrës është i autorizuar që të bëjë regjistrimin e mjeteve bazë të Odës në rast se Këshilli Drejtues nuk e bën regjistrimin, dhe për këtë Këshilli Mbikëqyrës do ta njoftojë Kuvendin në seancën e rregullt vjetore.

Këshilli mbikëqyrës është i autorizuar të bëjë propozime për shumën dhe mënyrën e mbledhjes së anëtarësisë, pagesën e mjeteve, fondeve të përmbareshësve, mënyrën e shpenzimit të mjeteve nga anëtarësia dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve nga gjobat, si dhe të bëjë propozime për të kërkuar donacione nga institucionet kompetente dhe të monitorojë mënyrën e disponimit të tyre nga Oda si dhe mënyrën se si Oda disponon me mjetet bazë në pronësi të Odës. Këshilli mbikëqyrës mund të ndërmerr dhe të parashtojë deri te Këshilli drejtues iniciativë për furnizimin e mjeteve elementare të Odës, si dhe iniciativa për ç' regjistrim të mjeteve bazë të Odës në përputhje me regjistrimin e zbatuar në Odë.

Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të inspektojë pasqyrat nga llogaritë e transaksioneve të Odës gjatë zbatimit të mbikëqyrjes mbi veprimtarinë financiare të Odës.

#### **Neni 42**

